

*Albanischer Kulturverein „Kosova“ e.V. Freiburg i. Br.  
Shoqata Kulturore Shqiptare „Kosova“ sh.r. Freiburg i. Br.*



## Rregullore: Turneu në Futboll të Vogël

<b>1. Përbërja e ekipit</b>	Ekipi përbëhet nga maksimum <u>10 lojtarë</u> . Ekipi nuk lejohet t'i ketë më shumë se 2 lojtarë të huaj. Në momentin e paraqitjes së ekipit paguhet kaucioni 100 €. Vetëm ekipi që e paguan kaucionin mund të regjistrohet për pjesëmarrje në turne.
<b>2. Paraqitja e listës së lojtarëve</b>	Një listë e plotë me <u>emrat dhe mbiemrat</u> si dhe <u>moshën e lojtarëve</u> duhet të paraqitet para fillimit të turneut. Në fletëparaqitje duhet të shënohet <u>vendi dhe koha e lajmërimit dhe regjistrimit</u> të ekipit. Çdo lojtar, emri i të cilit nuk përfshihet në këtë listë, nuk mund të marrë pjesë në turne. Një lojtar nuk mund të luajë për dy ekipe të ndryshme.
<b>3. Numri i lojtarëve gjatë lojës</b>	Ndeshjet zhvillohen sipas sistemit: <u>1 portier dhe 6 lojtarë</u> në fushë. Ndeshja nuk mund të zhvillohet nëse njëri nga ekipet ka më pak se 3 lojtarë.
<b>4. Veshja e lojtarit</b>	Një lojtar nuk mund të veshë asnjë veshje ose pajisje të cilat janë të rrezikshme për të ose për një lojtar tjetër (përfshirë çdo lloj të bizhuterive). Dy skuadrat duhet të veshin fanella me ngjyra që i dallojnë nga njëra-tjetra dhe nga gjyqtarët. Veshja e lojtarëve nuk duhet të ketë asnjë fjali me përmbajtje politike, fetare apo personale.
<b>5. Zëvendësimet</b>  <b>Zona teknike</b>	Zëvendësimet mund të kryhen në çdo kohë, edhe nëse topi është në lojë apo jo. Numri i zëvendësimeve që mund të kryhen gjatë një ndeshje është i pakufizuar. Lojtari rezervë mund të hyjë në fushën e lojës vetëm kur lojtari që do të zëvendësohet është larguar nga fusha e lojës. Zona teknike për lojtarët rezervë është mesi ndërmjet fushës 1 dhe 2.
<b>6. Goditjet e lira</b>	Të gjitha goditjet e lira (gjithashtu nga këndi dhe gjatë nisjes së lojës nga pika e mesit të fushës) duhet të ekzekutohen në mënyrë <u>indirekte</u> . Përrjashtimi i vetëm është: penalltia. Distanca e kundërshtarëve nga topi: 3 m
<b>7. Gjyqtarët</b>	Lojën e drejton një gjyqtar bashkë me një gjyqtar rezervë/vëzhgues anash fushës. Gjyqtarët do të ndalojnë menjëherë çdo sjellje jospportive dhe të pahijshme, p.sh. faull i ashpër ose

	<p>provokim, dhe nëse është e nevojshme e ndëshkojnë lojtarin me përjashtim nga loja.</p> <p>Gjyqtari mban shënime për ndeshjen.</p> <p>Pajisjet e gjyqtarit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bilbili i gjyqtarit</li> <li>• Kartonët e verdhë dhe të kuq</li> <li>• Fletore (ose mjete të tjera për të mbajtur shënime rreth lojës)</li> </ul>
<b>8. Përjashtimi i përkohshëm nga loja</b>	<p><u>Po (2 Minuta)</u></p> <p>Në rast se lojtari përjashtohet 2 herë nga 2 minuta, atëherë ai përjashtohet automatikisht nga turneu.</p>
<b>9. Ndërprerja, anulimi i ndeshjes, përjashtimi</b>	<p>Gjyqtari dhe organizatorët mund ta ndërpresin dhe përfundojnë me rezultat zyrtar 3:0 një ndeshje nëse:</p> <p>Ekipi luan shumë ashpër dhe ka sjellje jospportive dhe të pahijshme.</p> <p>Nëse në fushën e lojës futen persona të paautorizuar.</p> <p>Nëse ndodh një rrahje.</p> <p>Nëse shkelen rregullat e turneut.</p>
<b>10. Fusha e lojës</b>	<p>Në fushën e lojës lejohet të hyjnë vetëm ekipet që do të luajnë.</p>
<b>11. Kohëzgjatja e lojës</b>	<p><u>1 x 10 minuta</u>, pa ndërrime të anëve.</p> <p>Pauza mes ndeshjeve <u>2 minuta</u>.</p> <p>Nuk parashihet lojë shtesë.</p> <p>Finalja zgjat <u>2 x 10 minuta</u> (me ndërrim të anëve).</p> <p>Në rast se finalja përfundon me barazim, atëherë fituesi caktohet me penallti (5 penallti).</p> <p>Ekipet në radhë për ndeshje duhet të jenë të gatshme për lojë <u>5 minuta para fillim të lojës</u>.</p> <p><u>Mosparaqitja e ekipit në fushë</u> në kohën e paraparë sipas orarit të ndeshjeve rezulton me humbje të ndeshjes me rezultat zyrtar 3:0.</p>
<b>12. Kualifikimi</b>	<p>Ekipet janë të ndara në <u>4 grupe (A, B, C, D)</u> me nga <u>6</u> <u>ekipe</u>.</p> <p>Renditja në grupe bëhet sipas datës/kohës së lajmërimit të ekipit.</p> <p>Kualifikohen tutje <u>2 vendet e para</u>.</p>
<b>Faza eliminatore</b>	<p>Në çerekfinale luajnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A1-B2</li> <li>2. A2-B1</li> <li>3. C1-D2</li> <li>4. C2-D1</li> </ol> <p>Në gjysmëfinale luajnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fituesi i çerekfinales 1 – Fituesi i çerekfinales 3</li> <li>2. Fituesi i çerekfinales 2 – Fituesi i çerekfinales 4</li> </ol> <p>Ndeshja për vendin e tretë.</p> <p>Ndeshja finale.</p>

**13.** Në fund të ndeshjeve të fazës grupore, nëse ekipet kanë pikë të barabarta, kriteret për kualifikim të mëtejshëm janë:

1. Krahasimi i golaverazhit (Tordifferenz)
2. Krahasimi cili ekip ka shënuar më shumë gola (Anzahl Tore)
3. Krahasimi i drejtpërdrejtë (Direkter Vergleich)
4. Në rast se edhe pas këtyre kriterëve ekipet janë të barabarta, zhvillohet gjuajtja e penalltive.

Në çerekfinale, gjysmëfinale dhe finale, në rast se loja përfundon me barazim, do të zhvillohet menjëherë gjuajtja e penalltive.

**14. Shpërblimet (kupa dhe medaljet)**

1. Vendi i parë (kupë dhe medalje)
2. Vendi i dytë (kupë dhe medalje)
3. Vendi i tretë (kupë dhe medalje)
4. Ekipi FAIR Play (medalje)
5. Golashënuesi më i mirë (kupë dhe medalje)
6. Portieri më i mirë (kupë dhe medalje)
7. Lojtari më i mirë (kupë dhe medalje)
8. Lojtari më i ri (medalje)
9. Lojtari më i vjetër (medalje)

**EKIPI QË I SHKEL RREGULLAT E LARTPËRMENDURA PËRJASHTOHET NGA TURNEU!**

**Këpucët sportive me vida nuk lejohen!**

**LUTJA JONË PËR JU:**

**Tregoni respekt për ekipet dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë ditë festive!  
Turneu nuk është vetëm garë sportive, por ka të bëjë me miqësinë dhe solidaritetin!**

**Turneu në futboll është para së gjithash festë kombëtare dhe familjare!  
Ekipi organizativ**

UNSERE BITTE AN EUCH: Zeigt bei allem, was ihr an diesem Tag tut, Respekt und haltet an eurer Stärke fest: Teamgeist! Das Turnier steht im Zeichen der Freundschaft und Verbundenheit!  
Euer Organisations-Team

Është aprovuar nga Kryesia e SHKSH "Kosova" në Freiburg, më 25.06.2023